



Ne kemi zgjedhur. Mbaroi tani gjithçka?

➔ AKOMA JO GJITHÇKA.

E regjistrove fëmijën tënde? Tani është e rëndësishme t'i japësh atij/asaj kohë dhe hapësirë për t'u mësuar me këtë gjë. Kalo ndonjëherë tek porta e shkollës, blej librat që ai/ajo ka nevojë, shko tek festa e shkollës, shko në ditën e dyerve të hapura (prezantimit) edhe për herën e 2-të, ...

Sa më tepër që fëmija jote të ndihet i lidhur me shkollën dhe degën, aq më mirë është për të ardhmen e tij/saj!

van naar basise**secundair**

Një udhëzues për t'a shoqëruar fëmijën time në procesin e zgjedhjes



Fëmija juaj rritet. Kalimi në arsimin e mesëm po afrohet. Kjo është një gjë eksituese! Edhe për ju si prind. Ti mund t'a ndihmosh fëmijën tënde në këtë hap të madh!

Çfarë mund të bësh ti si prind?

Fëmija jote është zakonisht akoma shumë e re/e vogël për të parashikuar se cilat pasoja ka kjo zgjedhja për të ardhmen. Prandaj është e rëndësishme që ti je, si i rritur. Megjithatë fëmija jote e ka të mundur që, në këtë moshë, të shprehë se çfarë e bën atë të lumtur apo e trishton dhe se çfarë janë ëndërrat e tij/e saj për të ardhmen. Lëre fëmijën tënde që të përjetojë dhe të provojë sa më tepër të jetë e mundur. Ti mund të provosh që këto përshtypje t'i vendosësh në kohë afatgjatë. Për shembull: fëmijës tënde i pëlqejnë kuajt.

Por, a do të thotë kjo gjë që, ajo/ai dëshiron që për të gjithë jetën e saj të merret me rritjen e mbajtjen e kuajve? Fëmijët, që ndjekin një degë/profesion që i intereson e që dijnë t'a bëjnë mirë, dhe që janë në një shkollë ku ndihen mirë, japin rrezultate më të mira dhe janë më të lumtur.

Shumë kërkime shkencore tregojnë se kalimi në arsimin e mesëm mund të ketë pasoja të mëdha në karrierën e mëtejshme të fëmijës tënde. Pra bëhet fjalë për të gjetur përzierjen/balancën e duhur në mes të, nga njëra anë, një shkolle dhe dege që i përshtaten fëmijës tënde, dhe nga ana tjetër mbajtjes parasysht të mundësive pozitive pas gradës së 2-të dhe/ose 3-të. Edhe në shtëpi mund të bësh mjaft gjëra.

Përdori këto KËSHILLA bashkë me fëmijën tënde dhe kështu bëje atë një zgjedhëse të vetëdijshme/zgjedhës të vetëdijshëm. Motivoje fëmijën tënde që këto këshilla t'i diskutojë edhe me mësuesit në shkollë, me vëllain më të madh apo motrën më të madhe, me dajën/axhën apo tezen/hallën, ... Ata e nohin fëmijën tënde në një mënyrë tjetër nga ti.

Shiko dhe dëgjoje fëmijën tënde.

Ti e njehtë atë për një kohë më të zgjatë dhe më mirë se të tjerët. Fol me të mbi këto pyetje:

☉ Çfarë bën me dëshirë fëmija jote? Plotëso:

- + Fëmija ime rri me orë të tëra duke u marrë me ...
- + Fëmija ime bëhet e lumtur nga ...
- + Sytë e fëmijës sime shkëlqejnë nga (kur bëhet fjalë për) ...
- + Këto sfida i ndërmerr/gjëra i bën me dëshirë fëmija ime: ...

☉ Çfarë di të bëjë mirë fëmija jote?

A i provon ai/ajo gjërat e reja?

Fëmijët mund t'i bëjnë mirë disa gjëra ose mund të zhvillohen në fusha të ndryshme.

☉ Si sillet fëmija juaj?



Fëmija ime është i qetë, i zhurmshëm, i turpshëm, i lodhur, i gëzuar, nervoz, i hidhëruar, i frikësuar, ...

- + kur ai/ajo kthehet nga shkolla
- + në fundjavë (weekend)
- + gjatë një feste me shumë njerëz
- + kur ai/ajo po luan me, ose pa shokë
- + kur ai/ajo bën detyrat e shtëpisë ose punon për shkollën
- + kur ai/ajo duhet të bëjë një provim



Fillo NË kohë.

- ☉ **Periudha e regjistrimeve fillon në shkurt/mars.** Në disa qytete, si Antwerpen-i dhe Gent-i, duhet të bësh paraqitjen/regjistrimin e parë, rreth asaj periudhe, në një sistem qendror. Disa shkolla mbushen shpejt (s'ka shumë vende).
- ☉ **Ditët e dyerve të hapura (e prezantimit) programohen shpesh pas periudhës së regjistrimeve.** Pra është shumë vonë të fillosh zgjedhjen në klasën e gjashtë (jo më parë)! Por shumica e shkollave organizojnë gjithashtu një moment informativ para periudhës së regjistrimeve. Mundohu të kërkosh se kur bëhet kjo.
- ☉ **Bërja e zgjedhjes mund të zgjasë shumë.** Diskutimi me të tjerët, kërkimi i informacioneve dhe gjykimi se çfarë dëshiron fëmija jote, kërkon shumë kohë.
- ☉ **Merr/programo kohë të mjaftueshme për t'u informuar mbi/t'u njohur me shkollat dhe kujdesu që pas zgjedhjes tënde të mbesë kohë për të ndërtuar një lidhje me shkollën dhe degën e re.**



Mbledh informacione

☉ **Lundro/kërko, bashkë me fëmijën tënde, në internet.**

- + Në (faqen) www.vanbasisnaarsecundair.be mund të gesh këshilla të nevojshme, filma të shkurtër të këndshëm dhe sqarime të qarta se si është ndërtuar arsimi i mesëm.
- + Në (faqen) www.onderwijskiezer.be mund të gesh shkolla dhe degë në bazë të interesave të fëmijës tënde ose mund të testosh se cilat janë interesat e tij/saj. Mendohuni se çfarë interesache ka fëmija jote dhe krahaso ato me degët e studimeve: cilat lëndë jepen? Kjo është faqja e internetit e paanshme më e besueshme mbi arsimin e mesëm.
- + Vizito faqet e internetit të shkollave në lagjen tënde. Shiko fotografitë, lexo raportimet mbi ekskursionet shkollorë, lexo vizionin pedagogjik, se si sillen me prindërit,...
- + Grada e 1rë ndryshon nga njëra shkollë në tjetrën. Shiko se çfarë ofron shkolla dhe se cilat janë mundësitë pastaj në gradën e 2 të.
- + Raportimet, që inspektorët bëjnë mbi shkollat, mund t'i lexosh në internet në (faqen) www.onderwijs.vlaanderen.be/nl/doorlichtingsverslagen

☉ **Shko vizito shkollat e mesme.**

- + Bëj një listë se çfarë ti dhe fëmija jote gjykoni që është e rëndësishme tek një shkollë.
- + Kalo thjesht në afërsi të disa shkollave në lagjen tënde sapo mbaron orari shkollor apo në fillim të tij, për të parë atmosferën aty.
- + Pyet në shkollën fillore/bazë të fëmijës tënde se cilat shkolla të mesme do të vizitojnë me klasën.
- + Kërko në internet shkolla të tjera që të duken interesante. Për shembull me anë të Onderwijskiezer.
- + Shko që në klasën e pestë në ditët e dyerve të hapura (të prezantimit) në mënyrë që pastaj të mendohesh qetësisht (të kesh kohë për t'u menduar).
- + Kërko shkollës bazë një pasqyrë të ditëve informative dhe atyre të dyerve të hapura të shkollave të mesme në lagjen tënde.
- + Nëse nuk ke dëshirë të shkosh tek secila shkollë veçmas, atëherë shkolla bazë e di nëse ka panairë ku shkolla të ndryshme prezantohen njëkohësisht.

☉ **Fol me familjarët, të njohurit, miqtë e tu dhe profesionistët.**

- + Me anë të kompjuterit: Fëmija jote mund të bëjë pyetje në çdo moment tek Awel (www.awel.be). Pas këtyre kanaleve të bisedimeve është një bashkpunëtor profesionist që do t'a ndihmojë ose adresojë fëmijën tënde.
- + Tek klubet dhe organizatat: A bën pjesë fëmija jote në një klub apo organizatë? Edhe atje sigurisht që ka njerëz që mund të të ndihmojnë për shembull duke të treguar se ç'përshtypje kanë për fëmijnë tënde atje. Ose ndoshta ata njohin njerëz me profesione që i interesojnë fëmijës tënde? Ose nxënës që tashmë janë në shkollë të mesme?
- + Në shkollën bazë: Qindra nxënës e kanë hedhur hapin e madh për në shkollën e mesme nëpërmjet shkollës bazë. Pra mësuesi kujdestar i klasës, mësuesi i kujdesit dhe punonjësi i CLB-së (Qendra për Udhëzimin e Nxënësve) mund të të tregojnë shumë gjëra mbi shkollat në lagjen tënde, mbresat e ish-nxënësve dhe natyrisht edhe se është fëmija jote në shkollë. Është detyra e shkollës bazë që t'ju informojnë mirë ty dhe fëmijën tënde. Mos harro t'i pyesësh se, si do t'a bëjnë ata këtë gjë, kur do të bëhet dhe se çfarë do të dëgjojnë fëmijët në klasë për këtë gjë. Mos ki turp t'i diskutosh me ata pyetje apo dyshimet e tua, sepse ata nuk e dinë gjithmonë se çfarë këshille ti do nga ata.